



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

- Bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.17 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/29 të datës 03.08.2011;
- Procedurën për Qeverisjen e Kodeve Teknike/Operacionale;
- Kërkesën e KEK-ut të datës 12.03.2012, për transferimin e aseteve 220/x kV dhe 110/x kV si dhe fushave perkatëse së bashku me ndërprerësat e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK në KOSTT;
- Kërkesën zyrtare të Komisionit Qeverisë të Kodeve Operacionale të datës 23.04.2012, për amendamentimin e Kodit të Rrjetit, përkatësisht nenit 6 të Kodit të Kycjes;

në seancën e mbajtur me datë 15 qershor 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** amendamentet e dispozitave të neneve 6.3.1.1 dhe 6.6.1.3 të Kodit të Kycjes.

Arsyetim

- Në takimin e mbajtur me datë 03.04.2012 të Komisionit për Qeverisjen e Kodeve Teknike/Operacionale-KQKO, KOSTT-i ka paraqitur për shqyrtim kërkesën për amendamentimin e dispozitave 6.3.1.1 dhe 6.6.1.3 të Kodit të Kycjes të cilat kanë të bëjnë me transferimin e aseteve 220/x kV dhe 110/x kV si dhe fushave perkatëse së bashku me ndërprerësat e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK në KOSTT.
- Anëtarët e KQKO-së, pas analizave dhe diskutimeve u pajtuan që propozimet e KOSTT-it për amendamentimin e këtyre dy dispozitave të procedohen për aprovim në ZRRE.
- Kërkesa zyrtare për amendamentimin e dispozitave 6.3.1.1 dhe 6.6.1.3 të Kodit të Kycjes, është dërguar nga sekretari në emër të KQKO-së, për aprovim në ZRRE me datë 23.04.2012.
- Pas vlerësimit të kërkesës së KQKO-së dhe duke parë se ndryshimi i kufirit komercial, përkatësisht transferimi i aseteve 220/x kV dhe 110/x kV si dhe fushave perkatëse së bashku me ndërprerësat e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK në KOSTT nuk ndikon në kryerjen e aktiviteteve të të licencuarve, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes së versioneve, atëherë do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit

Bashkangjitur Vendimit janë dispozitat ligjore të amandamentuara.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar



DISPOZITAT LIGJORE TË AMANDAMENTUARA

6.3 Shpërndarja

6.3.1.1 Për transferin e energjisë elektrike mes Sistemit të Transmisionit dhe Sistemeve Shpërndarëse, kufiri komercial do të jetë në anën sekondare të tensionit të transformatorëve zbritës duke përfshirë dhe fushat përkatëse së bashku me ndërprerësin e transformatorëve 35 kV dhe 10(20) kV.

6.6 Pronësia dhe Funkionimi

6.6.1.3 OST është pronar i të gjitha pajisjeve elektrike – stabilimenteve dhe aparaturave – në anën e Sistemit të Transmisionit të pikës së kyçjes. OST do të jetë pronar, do të vë në operim dhe do të mirëmbajë pjesën e tensionit të lartë të nënstacionit në vendin e kyçjes, transformatorin zbritës dhe të gjitha asetet tjera të kyçjes të cilat mund të kërkohen për kyçjen në Sistemin e Transmisionit sipas “Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji”, Kodi të Rrjetit dhe dispozitave të MK.